

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin Bajram Miftari, duke vendosur në çështjen juridike sipas padisë së paditësit Kompania e Sigurimeve “S.M.” me seli në B.-Z., të cilin e përfaqëson ICS A.1 L.L.C nga P. – avokati B.N., kundër të paditurve: Kompania e Sigurimeve “E.”; Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Infrastrukturës; dhe Shoqëria Tregtare “A.2”sh.p.k, që të tria me seli në P., për shkak të kompensimit tëregresit nga sigurimi,vlera e kontestit 23.886.34 €, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 20.02.2018, me datën 02.03.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. MIRATOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania “S.M.” me seli në B.-Z., përkitazi me të paditurën e parë Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Infrastrukturës, ashtu që detyrohet padituraqë t’ia paguaj paditësit shumën prej 79,007.16 €, në emër të regresit për kompensimin e bërë mbi bazën e sigurimit pensional, me kamatëligjore prej 8% në vit, duke llogaritur nga paraqitja e padisë, gjegjësisht data10.02.2014, e deri në pagimin definitiv, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit së këtij aktgjykimi.

**II.Refuzohet** si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania “S.M.” me seli në B.-Z., sa i përket të paditurit të dytë, Shoqëria Tregtare “A.2”,sh.p.k, me seli në P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet në mënyrë solidare me të paditurin e parë për kompensimin e shumës 79,007.16 €, në emër të regresit.

**III.** Detyrohet i padituri Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Infrastrukturës, që t’ia paguaj paditësit shumën prej 9,623.80 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

**IV.** Detyrohet paditësi “S.M.”, që t’ia paguaj të paditurit të dytëShoqëria Tregtare “A.2”sh.p.k, shumën prej 7,458.00 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës konstetimore, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m i**

### Rrethanat procedurale të çështjes

Paditësi Kompania e Sigurimeve “S.M.” me seli në Z., më datën 09.07.2012, ka paraqitur padi kundër të paditurës, K.S “ E.” për kompensimin e dëmit nga regresi. Në padi dhe në parashtrimet e tjera të palës paditëse, ndër të tjera është theksuar se me datën 02.01.2013, në

rrugën magjistrale Pejë-Prishtinë, në fshatin K., ka ndodhur një aksident ku është përfshirë edhe automjeti i markës “MercedesBenz”, me targa regjistrimi ..., me pronar z. A.M.. Në aksidentin në fjalë, në cilësinë e pasagjeres, ka marrë lëndime të rënda trupore me pasojë vdekjeje, znj.M.M.. E ndjera M.j ishte e punësuar në Z., dhe nga baza e sigurimit të detyrueshëm pensional AHV, paditësi i ka përmbushë detyrimet, siç vijon: shpenzimet e transportit të trajtimit të dëmtuarës në relacionin Prishtinë-Zvicër, në shumën prej 15,599.45 CHF, shpenzimet e varrimit të ndjerës M., në shumën prej 2.422.00 CHF; akordimii pensionit familjar, në shumën prej 2.030.00 CHF në muaj, në shumën e përgjithshme prej 36,291.45 CHF. Më tej, ka theksuar se pronari i automjetit të aksidentuar në të cilin pasagjerja e lënduar - tani e ndjera M.M. ishte, kishte policë të sigurimit nga autopërgjegjësia të lëshuar nga e paditura K.S “E.”.

Me datën 11.08.2015, paditësi ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv, duke i përfshirë si palë të paditura edhe: Qeverinë e Republikës së Kosovës-Ministrinë e Infrastrukturës; dhe Shoqërinë Tregtare “A.2”, sh.p.k, që të dyja me seli në P..

Me aktgjykimin e kësaj gjykate, C.nr. 104/14, është vendosur në mënyrë meritore. Gjykata e Apelit e Kosovës, në procedurë ankimore, me aktvendimin Ae.nr.190/16, e ka prishur aktgjykimin e kësaj gjykate dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Paditësi, në rigjykim, përkatësisht në seancën e datës 30.05.2017, e ka tërhequr padinë e paraqitur kundër të paditurit K.S “Elsig”, dhe rrjedhimisht procedura ka vazhduar kundër të paditurve Ministria e Infrastrukturës dhe “A.2”, sh.p.k.

Në procedurë të rigjykimit, paditësi ka propozuar nxjerrjen e provës së ekspertizës së komunikacionit, nga një grup prej tre ekspertësh gjyqësorë. Të paditurit nuk e kanë kundërshtuar propozimin për nxjerrjen e kësaj prove. Gjykata, me aktvendim e ka miratuar propozimin e paditësit, ashtu që ka caktuar nxjerrjen e provës së ekspertizës së komunikacionit nga grupi prej tre ekspertësh, nga lëmi i komunikacionit, në përbërje prej: S.B., B.L. dhe S.Sh..

Grupi i ekspertëve e ka punuar raportin e ekspertizës dhe të njëjtin ia ka dorëzuar gjykatës me datën 10.06.2017. Të paditurit kanë dhënë vërejtje në raportin e ekspertizës së punuar, andaj, gjykata në seancën e datës 20.12.2017, eka detyruar grupin e ekspertëve që të punojnë një raport plotësues të ekspertizës. Grupi i ekspertëve e ka punuar raportin plotësues të ekspertizës, e po ashtu, ekspertët në fjalë kanë dhënë sqarime shitesë në seancën e datës 20.02.2018.

E paditura Ministria e Infrastrukturës, në seancat dëgjimore të mbajtura në rigjykim, ndër të tjera ka theksuar seka lidhur kontratë për mirëmbajtjen e rrugës ku ka ndodhur aksidenti “Regjioni i Prishtinë A”, me të paditurin “A.2” sh.p.k, dhe se kontrata ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur aksidenti, dt. 02.01.2013. Përgjegjësinë për mirëmbajtjen e rrugës e ka pasur i padituri “A.2” sh.p.k, andaj, e njëjta është përgjegjëse për të gjitha dëmet e shkaktuara në atë rrugë, për shkak të lëshimeve të saj.

E paditura "A.2" sh.p.k., në seancat dëgjimore të mbajtura në rigjykim, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësittë paraqitur kundër tij. Ndër të tjeraka theksuar se nga menaxheri i projektit nuk ka pasur paralajmërim apo udhëzim për intervenim në vendin ku është shkaktuar aksidenti. Ka shtuar se e ka respektuar kontratën e lidhur me të paditurën Ministria e Infrastrukturës, dhe se kjo vërtetohet me faktin se kontrata është ende në fuqi dhe se asnjëherë nuk ka marrë vërejtje për mos respektim të kontratës. Po ashtu, ka shtuar se sipas kontratës i padituri Ministria e Infrastrukturës ka pasur të drejtë që të bëjë ndalesën e 10 % të vlerës së kontratës në rast të mos përmbushjes apo përmbushjes së pa rregullt të kontratës. Ka mbajtur qëndrimin se punimet rreth mirëmbajtjes së rrugëve ika bërë në përputhje me rekomandimet e menaxherëve të të paditurit, Ministria e Infrastrukturës.

Paditësi, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e shqyrtuara në këtë çështje juridike ka rezultuar se të paditurit janë përgjegjës për aksidentin zingjirorë të ndodhur. Ka parashtruar se nga ekspertiza e grupit të eksperteve është konstatuar se shkaktar kryesorë i aksidentit në fjalë është rruga dhe mos mirëmbajta e saj. Ka parashtruar se ka bërë pagesa në emër të trajtimit mjekësor të aksidentuarës M.M. dhe të pensionit të familjarëve të saj. Më tutje ka elaboruar se i padituri i parë është përgjegjës për aksidentin duke u bazuar në nenin 8,12,13 të Ligjit për Rrugët (Ligji me numër 2003/11). Ndërsa, i padituri "A.2" sh.p.k, është përgjegjës për aksidentin duke u bazuar në faktin se i njëjti ka pasur të lidhur kontratë me të paditurën Ministria e Infrastrukturës, për mirëmbajtjen e rrugëve. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoj dhe me aktgjykim t'i detyroj të paditurit që në mënyrë solidare t'ia paguajnë shumën prej 79,007.16 €.

E paditura Ministria e Infrastrukturës, në fjalën përfundimtare e ka kontestuar kërkesëpadinë e paraqitur kundër tij. Ka theksuar se konform kontratës së lidhur, të paditurës Shoqërisë "A.2" sh.p.k, i takon përgjegjësia për mirëmbajtjen e rrugës. Sipas saj, kontrata e lidhur e obligon palën si mirëmbajtëse e rrugës që të vendos shenjën paralajmëruese të rrezikut nga akulli dhe në pikat e rrezikshme. Më tutje, ka parashtruar se me nenin 196.1 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin (Ligji nr. 02/L-70), është e përcaktuar se subjektit të cilit i është besuar mirëmbajtja e rrugëve detyrohet që t'i marrë të gjitha masat e duhura për të mënjanuar pengesat në rrugë siç janë: bora, shembjet, gurët etj. Ka theksuar se mbi këtë bazë edhe kallëzimi penal i është bërë menaxherit të të paditurit "A.2" sh.p.k. Ka përfunduar se në rastin konkret përgjegjësia për mirëmbajtjen e rrugëve i takon të paditurës "A.2sh.p.k" dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paraqitur ndaj saj ta refuzoj si të pabazuar.

E paditura, "A.2" sh.p.k, në fjalën përfundimtare e ka kontestuar kërkesëpadinë e paraqitur kundër saj. Ka theksuar se në relacionin kontraktues ka qenë vetëm punë kryes dhe se i ka kryer të gjitha detyrimet e marra me kontratë sipas udhëzimeve të menaxherit të kontratës dhe se në ditën e shkaktimit të aksidentit në vendin e shkaktimit të aksidentit nuk ka marrë asnjë paralajmërim apo udhëzim për formimin e akullit të zi. Ka mbajtur qëndrimin se nuk mund t'i atribuohet faji në lidhje me aksidentin, sepse me Ligjin për Rrugët, në mënyrë të qartë përcaktohet se Ministria është kompetente për mirëmbajtjen e rrugëve. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paraqitur kundër saj ta refuzojë si të pabazuar.

Gjendja faktike e konstatuar

Për të vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të plotë gjendjen faktike gjykata ka bërë administrimin e provave të lëndës, përmes leximit dhe shikimit të tyre, si në vijim: kallëzimi penal i datës 02.01.2013, me skicat e vendit të ngjarjes; vendimi për pensionin familjar i datës 09.03.2013; fatura e transportit ajro-ambulancë e datës 29.01.2013; fatura me numër 18029700 e datës 13.03.2013; ekstrakti i pagesave të shpenzimeve të varrimit dhe pensionit familjar në origjinal dhe përkthim, i datës 10.10.2013, dhe shtesat; imeli i datës 10.05.2013; imeli i datës 21.05.2013; imeli i datës 07.10.2013; deklarata e konfirmimit të pranimit të pagesave të pensionit familjar e datës 01.06.2015, me listën e datës 09.03.2015, dhe shtesatpërcjellëse; ekspertiza e punuar nga grupi i eksperteve të komunikacionit sipas lëndës C.nr.343/2013; vazhdimi i kontratës i datës 04.09.2012; padia e dorëzuar Gjykatës Themelore në Pejë, e datës 24.04.2013; aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj me numër C.nr.186/13; konfirmimi për sigurimin UVG i datës 16.06.2014; raporti mjekësor i Spitalit në Kantonin e Sengalen i datës 03.01.2013; konfirmimi i punëdhënësit i datës 13.04.2014 dhe 29.03.2016; polica e sigurimit me numër G-1199-1840, në origjinal dhe përkthim, ekstrakti nga BKQ, faqja zyrtare, lidhur me vlerën e valutave të huaja, e printuar me datën 16.05.2016; ditari ndërtimor i datës 02.01.2013 dhe 03.01.2013; ekspertiza gjyqësore e punuar nga grupi i eksperteve, e datës 10.06.2017; raporti plotësues i ekspertizës i grupit të eksperteve i datës 27.01.2018; para masat dhe paralogaritë; fatura me numër 4/2013; pjesë nga ditari ndërtimorë, kontrata e lidhurnë mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe A.2 sh.p.k, e datës 29.08.2011, për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe regjionale; dhe raporti i konvertimit të valutës nga CHF në Euro.

Pas administrimit të provave dhe vlerësimit me kujdes të tyre, secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, dhe konstatimit të fakteve jo kontestuese, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Ishte jo kontestuese në mes të palëve ndërgjyqësore me dt. 02.01.2013, në magjistralen Pejë-Prishtinë, në fshatin K., Komuna e F.K., ka ndodhur aksident i trafikut, ku ishin përfshirë 15 automjete në aksident. Pjesë e atij aksidenti zingjirorë ishte edhe automjeti i markës “MercedesBenz”, të cilin ishte duke e drejtuar z. A.M..
- Ishte jo kontestuese se në atë aksident është përfshirë edhe znj. M.M. e cila ka marrë lëndime të rënda trupore. Ajo ishte pasagjere në automjetin e markës “MercedesBenz”. Meqenëse pasagjerja ka pasur leje qëndrimi dhe sigurim shëndetësor në shtetin Z., ajo është transportuar menjëherë për në Z. dhe ka filluar trajtimin shëndetësor. E dëmtuara, si pasojë e lëndimeve të rënda dhe të papërballueshme që ka marrë në atë aksident, ka ndërruar jetë dhe është varrosur me dt.05.01.2013. Siguruesi S.M., i ka përmbushë detyrimet nga baza e sigurimit pensional, siç vijon:shpenzimet e transportit të të dëmtuarës në relacionin Prishtinë–Zvicër, në shumën prej 15,599.45 CHF; shpenzimet e varrimit të të ndjerës M.M., në shumën prej 2,422.00 CHF; dhe ka akorduar një pension familjar për familjarët e të ndjerës, në shumën prej 2,030.00 CHF në muaj;Pagesa e përgjithshme deri në ditën e mbajtjes së gjykimit ka arritur vlerën prej 91,101.45 CHF.
- Me qëllim të përcaktimit të shkaktarit të aksidentit, në rigjykim gjykata ka caktuar ekspertizë nga lëmi i komunikacionit dhe për punimin e sajë ka angazhuar grupinprej

tre ekspertësh gjyqësorë. Ekspertët kanë dhënë mendimin e tyre përmes raportit të ekspertizës dhe deklarimeve shtesë në gjykatë se lokacioni ku ka ndodhur aksidenti është një vend i prirur për krijimin e akullit të zi, dhe se shkaktar i aksidentit ka qenë mungesa e shenjave të rrezikut “*rrugë e rrëshqitshme*“ dhe “*ngrica në rrugë*”. Ekspertët kanë sqaruar më tutje se “*akulli i zi*” është një akull që nuk mund të vërehet nga vozitësit, madje i jep përshtypje vozitësit se rruga është e lagur. Pastaj, pas hyrjes së automjetit në zonën me shtresë akulli, është e vështirë të mbahet automjeti nënkontrollë për shkak të pjerrtësisë së terrenit. Ekspertët kanë deklaruar më tutje se lokacioni ku ka ndodhur aksidenti kërkon domosdo vendosjen e shenjave paralajmëruese të rrezikut në rrugë për shkak të rrezikut nga akulli i zi. Sipas tyre, në kohën e aksidentit në vendin e aksidentit, nuk ka pasur shenja të tilla paralajmëruese dhe se vozitësit nuk kanë mundur të shmangen nga aksidenti për shkak të veçorive të terrenit, siç u përshkruan më lartë dhe për shkak të mungesës së shenjave paralajmëruese, për të cilat arsye edhe ka ndodhur aksidenti zingjirorë.

Gjykata ka konstatuar se ekspertiza e punuar dhe sqarimet shtesë të dhëna nga ekspertët në masë të mjaftueshme e kanë sqaruar çështjen e shkaktarit të aksidentit, dhe se konstatimi i tyre është në përputhje të plotë me provat e tjera të lëndës. Andaj, gjykata ka bërë vlerësimin e fakteve, sipas rezultateve të ekspertizës së punuar nga grupi i eksperteve dhe provave të tjera të lëndës, duke ardhur kështu në përfundimin se shkaktar i aksidentit ka qenë mungesa e shenjave paralajmëruese të rrezikut në rrugë.

#### Baza juridike e kërkesëpadisë

Me nenin 939 paragrafi.1. të LMD-së është përcaktuar se me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vet ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e te siguruarit ndaj personit i cili mbi çfarë do baze është përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Paditësi si sigurues nga baza e sigurimit pensionalka bërë pagesa për transportimin e të ndjerës nga relacioni Prishtinë-Zvicër, ka bërë pagesa për varrimin e të ndjerës, po ashtu ka akorduar edhe pensionin familjar për familjen e të ndjerës M.M., në një shumë të përgjithshme prej 91,101.45 CHF.

Siç është elaboruar më sipër në këtë aktgjykim, paditësi ka paditur dy palë, me pretendimin se janë solidarisht përgjegjëse për dëmin e shkaktuar, edhe atë Ministrinë e Infrastrukturës dhe “A.2” sh.p.k. Rrjedhimisht, gjykata ka vlerësuar në mënyrë individuale, përgjegjësinë eventuale të tyre, mbi shkaktimin e dëmit.

Duke u nisur nga faktet tani më të konstatuara përmes ekspertizës së komunikacionit, se shkaktar i aksidentit zingjirorë dhe i pasojave lidhur me të ndjerën M.M. ka qenë mungesa e dy shenjave paralajmëruese të rrezikut në rrugë, në vlerësimin juridik të kësaj gjendje faktike është parashtruar si çështje për zgjidhje se kush ka qenë përgjegjës për vendosjen e shenjave të lartcekura.

Në kohën e ndodhjes së aksidentit, dt. 02.01.2013, ka qenë në fuqi Ligji për Rrugët (Ligji nr. 2003/11). Me këtë Ligj, neni 5.1, është përcaktuar se “*Ministria është autoritet për Rrugë Publike Magjistrale dhe Regjionale*”. Pastaj, me nenin 8.1 të të njëjtit ligj, është përcaktuar se

*“Ministria është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin rrugëve magjistrale dhe regjionale”.*

Me Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor (Ligji nr. 02/L-70), neni 13.1. është vënë rregulli se *“Rrugët publike duhet të shënohen me sinjale të parapara të komunikacionit, me të cilat pjesëmarrësit në komunikacion paralajmërohen për rrezikun që u kanoset në rrugën e caktuar publike ose në një pjesë të saj, njoftohen për kufizimet, për ndalimet dhe për obligimet të cilave duhet t’iu përmbahen pjesëmarrësit në komunikacion dhe japin njoftime të nevojshme për zhvillimin e sigurt dhe të papenguar të komunikacionit”.*

Konform këtyre dispozitave ligjore dhe krahasimit të tyre me dispozitat tjera ligjore nga lëmi i komunikacionit rrugor, gjykata ka ardhur në përfundimin se kompetencat dhe përgjegjësitë për vënien e shenjave të komunikacionit rrugor, duke përfshirë edhe përgjegjësinë për vendosjen e shenjave që do të duhej të vendoseshin në lokacionin ku ka ndodhur aksidenti, e kishte Ministria e Infrastrukturës.

Padyshim se lënia e rrugës në mungesë të shenjave të paralajmërimit të rrezikut nga rrëshqitja dhe ngricat, në një lokacion që ka prejudikuar domosdoshmërinë e vendosjes së shenjave të tilla, ka shkaktuar dëme, të cilat paditësi i ka kompensuar si sigures. Me nenin 136.1 të LMD-së është paraparë që: *“Kushi shkaktonte tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”.* Në këtë rast, dëmi nga e paditura Ministria e Infrastrukturës, është shkaktuar me mosveprim. Me Komentarin e LMD-së, është theksuar me të drejtë se *“Fakti dëmtues mund të jetë aktiv ose pasiv... Pasiv është nëse personi përgjegjës nuk ka ndërmarrë një veprim të caktuar, të cilin me ligj ka qenë i detyruar ta ndërmarrë”.* Po ashtu, Komentari thekson se *“për të ekzistuar përgjegjësia e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar, ai duhet të jetë shkaktuar me veprim, përkatësisht me mosveprim të kundërligjshëm. Në mënyrë të kundërligjshme vepron personi që me veprimin e vet apo mosveprimin e vet shkelë ndonjë normë të caktuar”* (Shih Komentarin e LMD-së, Libri I, Ministria e Drejtësisë, 2013, faqe 158,160). Nga kjo shihet se Ministria e Infrastrukturës ka shkelur detyrimet e saj ligjore për vendosjen e shenjave adekuate të trafikut, kështu që, përmes mos përmbushjes së detyrimeve të saj ligjore, duke qëndruar pasive në relacion me lokacionin me rrezik permanent gjatë sezonit dimëror, drejtpërdrejtë ka shkaktuar dëm tek pala e tretë, të cilin dëm e ka kompensuar paditësi që tani kërkon regresimin e atij dëmi të kompensuar.

Pjesë e vlerësimit dhe e vendosjes ka qenë pretendimi i paditësit se edhe Shoqëria Tregtare “A.2” sh.p.k, është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar dhe rrjedhimisht edhe për regresimin e paditëses. Njëherit, edhe e paditura Ministria e Infrastrukturës, gjatë gjykimit ka pretenduar se përgjegjësia për dëmin dhe për mbulimin e tij përmes regresit, i takon ekskluzivisht të paditurës “A.2” sh.p.k. Të dy palët e lartcekura pretendimet e tyre i kanë mbështetur mbi faktin se në kohën e aksidentit, të paditurat kanë qenë në raport kontraktues nga *“Kontrata për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjinale të Republikës së Kosovës, regjioni P. A”*, ku Ministria ka pasur cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ndërsa “A.2” sh.p.k, cilësinë e Kontraktuesit, gjegjësisht ofruesit të shërbimit të mirëmbajtjes së rrugës. Në vlerësimin e kësaj çështjeje gjykata ka marrë për bazë posaçërisht dispozitat e kontratës që iu referohen *“aktiviteteve të mirëmbajtjes dimërore”.* Në kuadër të kësaj pjese, është vendosur një paragraf i veçantë, *“Paralajmërimet për Akullin e Zi në Zonat e*

Rrezikut”,ku është theksuar se: *“Kontraktuesi duhet të siguroj, sipas sugjerimeve të Menaxherit Lokal të bazuar në përvojën e tij shumëvjeçare, vendosjen e shenjave paralajmëruese për rrëshqitje në sipërfaqe të veçanta të rrjetit rrugor të cilat janë të prirura për formimin e akullit të zi”*. Më tutje, në paragrafin 6 “Punët Ditore”, është përcaktuar se *“këto punë do të instruktohen në mënyrë të qartë me shkrim nga Projekt Menaxheri, para se kontraktuesi të marrë masat individuale”*. Gjykata potencon se Kontrata ka përdorur terma të ndryshëm për të njëjtin pozicion zyrtar si *“Menaxheri Lokal”, “Projekt Menaxheri” dhe “Menaxheri i Projektit”,* e që në esencë është fjala për të autorizuarin e Ministrisë së Infrastrukturës, kompetent për menaxhimin me Kontratën.

I padituri “A.2” ka pretenduar gjatë gjykimit se asnjëherë nuk i është sugjeruar nga Menaxheri, vendosja e shenjave në lokacionin ku ka ndodhur aksidenti. E paditura Ministria e Infrastrukturës, nuk ka mundur ta provoj të kundërtën. Me provat e lëndës nuk është provuar se i padituri Ministria e Infrastrukturës, gjegjësisht menaxheri i autorizuar, të ketë sugjeruar apo rekomanduar të paditurën “A.2”, që të vendos shenjat paralajmëruese të rrezikut në zonën ku ka ndodhur aksidenti.

Çështja e radhës me të cilën është marrë gjykata ka qenë se në mungesë të shenjave paralajmëruese të rrezikut, a ka pasur përgjegjësi e paditura “A.2”, për mirëmbajtjen e aksit rrugor ku ka ndodhur aksidenti. Përmes ekspertizës, gjykata ka konstatuar se lokacioni ka qenë i mbuluar me akull të zi, në kohën e aksidentit. Po ashtu, aksidenti ka ndodhur në sezon dimëror, gjegjësisht me dt. 02 janar 2013. Sipas grupit të ekspertëve, për tu formuar akulli i zi, ka dy kushte: 1) që lokacioni të përballet me shi apo me mjegull; dhe 2) që temperaturat të bien nën zero gradë celsius. Sipas grupit të ekspertëve, në ditën e aksidentit ka pasur mjegull në atë lokacion dhe është formuar akulli i zi, prej nga rezulton se temperaturat ishin nën zero gradë celsius. Në parim, detyrim kontraktues i të paditurit “A.2”, ka qenë heqja e akullit nga rruga. Në paragrafin e kontratës *“Masat për t’iu kundërvu akullit”,* është theksuar: *“Kripa akull shkrirëse nuk ka ndikim në shtresa të akullit në temperatura të ulëta. Shtresa të tilla, mund të hiqen vetëm në mënyrë mekanike duke përdorur grejderin ose të ngjashme. Është esenciale që kontraktuesi të ketë në dispozicion pajisje të tilla”*.

Mirëpo në ditën kritike kur ka ndodhur aksidenti, lokacioni ka qenë i mbuluar me akull të zi, ndërsa në pjesën tjetër të aksit rrugor nuk është evidentuar kurrfarë akulli. Pra, rruga dhe kushtet e saj, nuk kanë prejjudikuar atë ditë masa të veçanta për heqjen e akullit. Për këto arsye nuk ka pasur interventime për largimin e akullit. Përrjashtimisht, problemi është paraqitur vetëm në lokacionin ku ka ndodhur aksidenti, nga se ka qenë zonë e prirur për krijimin e akullit të zi. Ministria e Infrastrukturës nuk e ka njoftuar apo sinjalizuar Shoqërinë “A.2”, që ai lokacion është i prirur për krijimin e akullit të zi, përmes ndonjë njoftimi të veçantë apo përmes vendosjes së shenjave paralajmëruese të rrezikut nga ngricat dhe rrëshqitjet. Sikur të kishte bërë një gjë të tillë, do të kishim një vëmendje të shtuar dhe të posaçme të Shoqërisë “A.2”, mbi atë lokacion, dhe do të rritej përgjegjësia e kësaj Shoqërie mbi atë lokacion, edhe në rrethanat si në rastin konkret kur aksi rrugor në përgjithësi ishte i qarkullueshëm dhe pa rreziqe apo pengesa nga bora dhe akulli.

Po ashtu, gjykata e ka pranuar si të besueshëm edhe mendimin e ekspertëve se shkak i aksidentit të trafikut ka qenë mungesa e shenjave paralajmëruese të rrezikut të rrugë, *“ngrica në rrugë”* dhe *“rrugë e rrëshqitshme”*. Nga kjo gjykata ka ardhur në përfundimin se sikur të

ekzistonin këto shenja në lokacionin me akull të zi, vozitësit do të kishin për detyrim që të zvogëlojnë shpejtësinë e lëvizës dhe të shtojnë kujdesin në vozitje përgjatë atij lokacioni. Përndryshe, edhe sikur të ndodhte aksidenti, goditjet nga shpejtësia e zvogëluar do të ishin më të dobëta dhe me siguri që pasojat do të ishin shumë më të vogla.

Mbi bazën e gjithë kësaj, gjykata ka ardhur në përfundimin se e paditura Shoqëria Tregtare "A.2", nuk është përgjegjëse për aksidentin e ndodhur me dt. 02.01.2013, e as për pasojat apo dëmet që janë shkaktuar në atë aksident. Rrjedhimisht, nuk është përgjegjëse as për regresimin e paditësit.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar me lartë dhe konform dispozitave ligjore të cituara, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësi është e bazuar vetëm ndaj të paditurit të parë Ministria e Infrastrukturës.

Meqenëse paditësi ka bërë pagesat në valutën e CHF, gjykata ka bërë konvertimin e valutave, nga CHF (Franga Zvicereane) në € (Euro), duke përdorur faqen e internetit [XE CorrenyCoverter](#). Kursi valutor i ekzaminuar nga gjyqtari i çështjes me dt. 20.02.2018, ishte siç vijon: 1 € = 1,15308 CHF. Nga kalkulimi i bërë ka rezultuar se shuma prej 91,101.45 CHF, është e barabartë në shumën prej 79,007.16 €. Pasi që kërkesëpadia e paditësit e paraqitur ndaj të paditurit të parë Ministria e Infrastrukturës, ka rezultuar si e bazuar dhe e provuar në aspektin e lartësisë së saj, gjykata e ka miratuar atë, duke e detyruar të paditurën në fjalë që paditësit t'ia paguaj të njëjtën shumë, në emër të regresit të pagesave të bëra si sigurues.

Gjykata e miratohet kërkesëpadinë edhe përkitazi me kamatën e kërkuar të vonesës, në shkallën prej 8 % në vit, duke vendosur kështu në përputhje me nenin 382.2 të LMD-së.

### Shpenzimet procedurale

Objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte edhe çështja e shpenzimeve të procedurës kontestimore. Paditësi ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe e ka bërë specifikimin e tyre. Edhe i padituri A.2sh.p.k, ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore po ashtu edhe e ka bërë specifikimin e tyre.

Gjykata ka vendosur edhe për shpenzimet e shkaktuara në procedurë konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe konformtarifës së Odës së Avokateve të Kosovës (OAK), palës paditëse i janë miratuar, shumat si në vijim: në emër të përpilimit të padisë shuma prej 624.00 €; në emër të taksave gjyqësore për padi dhe për aktgjykim, shuma prej 823.00 €; në emër të 4 parashtrësive shumën prej 1,248.00 € ( $4 \times 312.00 = 1,248.00$ ); në emër të përgjigjes në ankesë shumën prej 624.00 €; në emër të ekspertizës së komunikacionit 900.00 €; për përfaqësim në 4 seanca dëgjimore, në lëndën I.C.nr.104/14 shumën prej 2,160.00 €; në emër të përfaqësimit në 5 seanca dëgjimore lëndën me numër I.EK.nr.226/17 shumën prej 2,704.00 € ( $5 \times 540.80 = 2,704.00$  €), në emër të 2 seancave të shtyra në shumën prej 540.80 € ( $2 \times 270.40 = 540.80$ ), në shumën e përgjithshme prej 9,623.80 €.

Duke ju referuar dispozitës së lartës cekur të LPK-së dhe Tarifës së Odës së Avokateve të Kosovës, gjykata ia ka miratuar kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të procedurës



kontesimore edhe të paditurit të dytë “A.2” sh.p.k. Duke e detyruar paditësin si palë e cila e ka humbur procesin gjyqësor në raport me të paditurin “Arbotek” sh.p.k, që të njëjtit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore siç vijon: në emër të përgjigjes në padi shuma prej 416.00 €; në emër të ankesës shumën prej 416.00 €; në emër të parashtresës së datës 12.10.2017, shuma prej 416.00 €; në emër të përfaqësimit në 11 seanca dëgjimore shumën prej 5,940.00 € (11X540.00=5,940.00 €), në emër të një seancë të shtyrë shumën prej 270.00 €, në shumën e përgjithshme prej 7,458.00 €.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Ekonomike**  
**I.EK.nr.226/17, me datën 02.03.2018**

Gjyqtari  
Bajram Miftari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të tij.